



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr ____prot

Urë Vajguore më ____/____/2025

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksion rrugesh me rere bituminoze, rruge lagje
Poshnje “Velaj”, Allambrez dhe me asfalt rruga “Paqeruajtesit Poshnje-Bashkia
Dimal”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TËPROKURIMIT: Punë ndërtimi
45000000-7**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 18 271 570 (tetëmbëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e
një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh.**

**KOHEZGJATJA E KONTRATES/MARREVESHJES KUADER OSE AFATI PER
ZBATIMIN E SAJ: 3 (tre) muaj kalendarikë.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **BASHKIA DIMAL**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit **financiare (2022, 2023, 2024)** lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të balanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (**2022, 2023, 2024**) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet

*kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se **50 %** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet

1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore perkatese të deklaruara në organet tatimore.
- Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

- 1.1** Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën/Marrëveshjen e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit, ku te jenë të shprehura qartë ndarja/lloji i punimeve që i përket secilit operator.
- 1.2** Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, Kolaudimin e punimeve Situacionin përfundimtar, Formularin e vlerësimit; si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor, Situacionin përfundimtar të nënkontraktorit, Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohetpër punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe,

në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, *Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*” të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme në ndërtim:

- **NP-1 A** Punime germimi në tokë;
- **NP-4 B** Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, .etj;
- **NP-9 A** Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime;
- **NP -12 A** Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **NS-1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve.
- **NS-6 A** Sinjalistika rrugore jondriçuese.
- **NS-18 A** Punime Topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për

ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"* të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

-Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP 1 A	Punime gjurmimi në tokë	Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore, Referuar projektit dhe specifikimeve teknike (referuar vlerës së punimeve të preventivit)	A (0- 20 milionë lekë)
NP-4B	Rruge,autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista,aeroportuale	Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë.. Referuar projektit dhe specifikimeve teknike (referuar vlerës së punimeve të preventivit).	B (21-50 milionë lekë)

NP-9A	Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.	Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme. Referuar projektit dhe specifikimeve teknike (referuar vleres së punimeve furnizim dhe vendosje tombino, tuba betoni për sistemimin e ujërave).	A (0- 20 milionë lekë)
NP-12A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	Punimet për ndërtimin e objektit kanë impakt mjedisor në të gjithë zonën përreth saj duke pasur parasysh pozicionimin e saj në zonë të banuar urbane, sasinë e madhe të mbetjeve të gjeneruara. Referuar projektit dhe specifikimeve teknike (referuar vleres së punimeve që kanë impakt/ndryshim mjedisor).	A (0- 20 milionë lekë)
NS-1A	Punime për prishjen e ndertimeve.	Referuar projektit dhe specifikimeve teknike. Referuar preventivit mbi Punimet për prishjen e ndertimeve ekzistuese rrugore, shtresave ekzistuese, prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, sistemimin, etj.	A (0- 20 milionë lekë)
NS-6A	Sinjalistika rrugore jondriçuese	Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare. (Referuar preventivit mbi sinjalistika rrugore jondriçuese, vijeze dhe tabela)	A (0- 20 milionë lekë)
NS-18A	Punime topogjeodezike	Referuar projektit dhe specifikimeve teknike (referuar vleres së punimeve Punime matje volume dhe piketimi si dhe procesit të matjeve rievimeve topogjeodezike të gjithë volumeve të punimeve).	A (0- 20 milionë lekë)

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- Kontratë pune e vlefshme;
- Diplomë.
- C.V (përkatëse)

Shënim: Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: *“drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi”* si dhe pikës 2.1 ku citohet se *“drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.*

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit”* dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: *“Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.*

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

- 2.3.4** Një punësim minimalisht prej **33 (tridhjetë e tre) punonjës**, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetimi të lëshuar nga Administrata Tatimore për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për **3 muajt** e fundit të deklaruar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Nëpërcaktimin e numrit të punonjësve specialistë i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përse kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën **33 punonjës** duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve, shtrirjes së objektit të kontratës në territor. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar në katër elementet e struktureve të kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore)

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë puntorë që kërkohet për realizimin e punimeve është min **33 punonjës**.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të perfshire në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- **1 (një) Inxhinier Ndertimi**
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- **1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder**

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve rrugore sipas parashikimeve në projekt-preventiv.
- **Inxhinier Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore furnizim vendosje tombino, kullim ujrash sipërfaqësor dhe natyror etj. lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv.
- **Inxhinier Topograf/ Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve që përfshin kuota dhe piketime, punime matje volume dhe piketimi si dhe procesit të matjeve rëlevimeve topogjedoze të gjithë volumeve të punimeve, lidhur me punimet e parashikuara në projekt-preventiv.

2.3.6 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe staf, jo domosdoshmerisht drejtues teknik, mjafton të jete punesuar pranë operatorit ekonomik ofertues si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit, si më poshtë:

- **1 (një) Inxhinier Ndertimi Infrastruktura Transporti.**
- **1 (një) Inxhinier Topograf/ Gjeodet/Markshajder.**
- **1 (një) Inxhinier Mjedisi.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese të DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

*Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe C.V si edhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për **3 muajt** e fundit.*

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin e mësipërm, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të infrastruktures së transportit, mjedisi, gjeodet etj. është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Inxhinier Mjedisë është përgjegjës për zgjidhjen e problemeve mjedisore për mbrojtjen e mjedisit lidhur me punimet e parashikuara në projekt-preventiv të cilat kanë impakt mjedisor në të gjithë zonën përreth saj duke pasur parasysh pozicionimin e saj në zonë e banuar urbane, sasinë e madhe të mbetjeve të gjeneruara.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar jo domosdoshmërisht të përfshirë në licencën e shoqërisë është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën

profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.7 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kete si staf mbështetës (me kontrate pune/kontratë bashkëpunimi) si më poshtë:

a) 1 (një) punonjës “**Ekspert zjarrefikes MNZSH**” në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4. Ky specialist mund te kontraktohet dhe me kontrate sherbimi.

b) 1 (një) punonjës me certifikatë "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (të vlefshme).
- Diplomë/Çertifikatë.
- të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajit e fundit

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të

përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- 1 (një) specialist Ekspert Zjarifikës **MNZSH** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin rekomandohet të jetë në kantier për marrjen e masave të menjehershme në rastet e zjarreve në kantier.
- 1 (një) punonjës me certifikatë "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**" rekomandohet të jete në kantier për trajnimin e punonjësve të kantierit me qëllim minimizimin e aksidenteve në punë.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë” si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

STAF TEKNIK	
Teknik Ndërtimi	1
Teknik Gjeodet/Topograf	1
Eskavatorist	3
Buldozerist	2
Shofer	5
Automakinista	2

2.3.8/1 Për punonjësit eskavatorist/ buldozerist/automakinist/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi, certifikate e aftesimit profesional (CAP) për shoferet dhe dëshmi aftesimi profesional (DAP) për manovratorët-automakinistët/eskavatoristët, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet

për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Per Teknikun e ndertimit, topograf/gjeodet te paraqitet diplome e shkolles se mesme profesionale, kontratë individuale të punës.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punonjesit ne certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indentifikues i certifikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1					
2					
...					

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit

Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Përcaktimi i numrit të punonjesve dhe profesionet është bazuar mbi zerat dhe volumet e punës si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të të cilave janë bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **grafikun e punimeve** të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për **3 (tre) muaj kalendarikë**.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

2.3.10 Operatori Ekonomik duhet të disponojë, ose të ketë marrëveshje bashkepunimi/shërbimi dhe të paraqesë një kontratë/marrëveshje noteriale të lidhur me një **laborator të akredituar** nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, me afat vlefshmërie në përputhje me afatin e kryerjes së punimeve objekt kontrate, për analizat e binderit, asfaltobetonit dhe materialeve inerte çakellit, stabilizant.

Argumentimi: *AK argumenton se kërkesa për një laborator testimi të asfaltobetonit (binder), çakëll, stabilizant etj., i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 2 dhe 4.*

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/EN/UNI **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/EN/UNI **ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë

akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

- c) Çertifikatën SSH/ EN/UNIISO 45001:2018 e përditësuar, (SSH/EN/UNI ISO 45001 – 2023) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Çertifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Argumentim: *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.10 gërma “a”- “d” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra

ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO45001-2018/45001-2023 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Standartet e kërkuara si dhe garancitë që vijnë nga certifikimi i kërkuar lidhen në mënyrë të përmbledhur me cilesinë, mjedisin dhe shëndetin në punë, objektiva detyruese për cilindo pjesëmarrës në procesin e zbatimit.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga secila shoqëri pasi kanë karakter të përgjithshëm dhe lidhen ngushtesisht me secilin proces pune që mund të marrë përsipër të realizojë zërat e parashikuara sipas Preventivitit secila shoqëri anëtare e bashkimit të operatorëve ekonomik.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.12 Operatori Ekonomik duhet të disponojë:

Licënsa të leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Transport i mbetjeve jo të rrezikshme nga ndërtimet dhe prishjet), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/B të këtij ligji”.

Në shtojcën I/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën **për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”. Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

2.3.13 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njësi	Sasi/cope	Statusi
1	Kamion kapacitet mbajtës mbi 25 ton	copë	4	Në pronësi ose me qera
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës (3-4 ton)	copë	4	Në pronësi ose me qera
3	Fadrome/Skrep Kove perpara dhe mbrapa	copë	2	Në pronësi ose me qera
4	Eskavatore me zinxhirë	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Eskavator me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Buldozer	copë	2	Në pronësi ose me qera
7	Minieskavator	copë	2	Në pronësi ose me qera
8	Minifadrome	copë	2	Në pronësi ose me qera
9	Grejder	copë	2	Në pronësi ose me qera
10	Rrul Vibruës Gome – Hekur mbi 18 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Rrul me Kompresor dhe Vibrim min.10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Rrul Hekur – Hekur mbi 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Rrul me dhëmbë mbi 7 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Rrul Gome – Gome per Asfalt mbi 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Asfaltoshtuese	copë	2	Në pronësi ose me qera
16	Autobitumatriçe	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Autovinc/kamion me vinc mbi 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Paisje topografike/topogjeodezike GPS	copë	1	Në pronësi ose me qera
20	Gjenerator mbi 50Kva	copë	2	Në pronësi ose me qera
21	Pirun ngritës	copë	2	Në pronësi ose me qera
22	Makineri Vijeziimi rrugor	copë	1	Në pronësi ose me qera

23	Batipal/montues Tabela Sinjalistike	copë	1	Në pronësi ose me qera
24	Depozita Uji 1000 litra	copë	5	Në pronësi ose me qera
25	Zyrë mobile (e levizëshme) kantieri	copë	1	Në pronësi ose me qera
26	Semafore per Sinjalistiken rrugore	copë	2	Në pronësi ose me qera
27	Prozhektore ndricimi	copë	10	Në pronësi ose me qera
28	Tabela sinjalistike sigurimi teknik	copë	25	Në pronësi ose me qera
29	Fikse zjarri	copë	25	Në pronësi ose me qera
30	Jeleke pune	copë	33	Në pronësi ose me qera
31	Kaska/Kokore	copë	33	Në pronësi ose me qera
32	Rimorkiator - Terheqes	copë	1	Në pronësi ose me qera
33	Rimorkio kapacitet mbajtes mbi 30 ton per transportin e makinerive te renda per ne kantier (eskavatora, rrula, grejdera, buldozera etj.)	copë	1	Në pronësi ose me qera

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi do të paraqiten keto dokumenta:

- Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- Për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerash/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, (*Autobitumatrice*) duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, Fatura tatimore ose deklarata doganore, apo marrjen me qira me kontrate noteriale.
- Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrate. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrata. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Nr	Emri i mjetit	Njësi	Sasi/copë	Argumentimi
1	Kamion kapacitet mbajtës mbi 20 ton	copë	6	Ne funksion të realizimit të zerave transport dheu, inerte, çakull, stabilizant, binder, etj. sipas volumeve dhe perlllogaritjeve të preventivit të kontratës.
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës (3-4 ton)	copë	4	Ne funksion të transportimit për në kantier të materialeve, paiseve të punës, etj. sipas

				volumeve dhe perlllogaritjeve te preventivit te kontrates.
3	Fadrome/Skrep Kove perpara dhe mbrapa	copë	2	Eshte i nevojshem per punime germim kanalesh
4	Eskavatore me zinxhirë	copë	1	Eshte i nevojshem per punime germim ku nuk perdoren mjete germuese me goma
5	Eskavator me goma	copë	1	Ne funksion te realizimit te zerave te germimit, sipas volumeve dhe perlllogaritjeve te preventivit te kontrates.
6	Buldozer	copë	2	Ne funksion te realizimit te zerave te sistemimeve te germimit dhe trasese se akseve rrugore, sipas volumeve dhe perlllogaritjeve te preventivit te kontrates.
7	Minieskavator	copë	2	Ne funksion te realizimit te zerave te germimit ku nuk mund te kryhen nga mjetet e zakonshme.
8	Minifadrome	copë	2	Ne funksion te realizimit te levizjeve ne volume te vogla te inerteve ku nuk mund te kryhen nga mjetet e zakonshme.
9	Grejder	copë	2	Ne funksion te hapjes dhe nivelimin e materialeve si cakell dhe stabilizant ne rruge
10	Rrul Vibruet Gome – Hekur mbi 18 ton	copë	1	Ne funksion te ngjeshjes se materialeve si cakell dhe stabilizant ne rruge
11	Rrul me Kompresor dhe Vibrim min.10 ton	copë	1	Ne funksion te ngjeshjes se materialeve si cakell dhe stabilizant ne rruge
12	Rrul Hekur – Hekur mbi 10 ton	copë	1	Ne funksion te ngjeshjes se shtresave asfaltike apo rere bituminoze
13	Rrul me dhëmbë mbi 7 ton	copë	1	Ne funksion te ngjeshjes se trasese se rruges
14	Rrul Gome – Gome per Asfalt mbi 10 ton	copë	1	Ne funksion te ngjeshjes se shtresave asfaltike apo rere bituminoze
15	Asfaltoshtuese	copë	2	Ne funksion te hapjes dhe nivelimin e materialeve asfaltike
16	Autobitumatriçe	copë	1	Ne funksion te hedhjes se prajmerit, emulsionit te bitumit.
17	Autobot uji	copë	1	Ne funksion sperkatjes me uje gjate realizimit te shtresave per eliminimin e ndotjes mjedisore etj.
18	Autovinc/kamion me vinc mbi 10 ton	copë	1	Ne funksion te levizjes dhe montimit te tobinove te betonit
19	Paisje topografike/topogjeodezike GPS	copë	1	Mjet per punime matje volume dhe piketimi si dhe procesit te matjeve rilevimeve topogjedoze
20	Gjenerator mbi 50Kva	copë	2	Eshte i nevojshem per te patur energji elektrike te pandërprere ne kantier

21	Pirun ngritës	copë	2	Ne funksion te levizjes dhe montimit te tombinove te betonit, tabelave etj.
22	Makineri Vijezi rrugor	copë	1	Ne funksion te realizimit te vijezeve rrugore
23	Batipal/montues Tabela Sinjalistike	copë	1	Ne funksion te montimit te tabelave dhe sinjalistikes vertikale
24	Depozita Uji 1000 litra	copë	5	Ne funksion te ruajtjes se ujit dhe levizjes se tij ne kantier atje ku eshte e nevojshme.
25	Zyrë mobile (e levizëshme) kantieri	copë	2	Ne funksion te stafit teknik, mbajtjes se dokumentacionit teknik, paisjeve individuale dhe nevojave te stafit.
26	Semafore per Sinjalistiken rrugore	copë	2	Ne funksion te sigurise rrugore dhe levizshmerise se mjeteve gjate punimeve.
27	Prozhektore ndricimi	copë	10	Ne funksion te ndricimit te kantierit gjate kohes qe mungon ndricimi natyral.
28	Tabela sinjalistike sigurimi teknik	copë	25	Ne funksion te sigurise teknike dhe sinjalistikes ne kantier.
29	Fikse zjarri	copë	25	Ne funksion te sigurise ne kantier, dhe shpetimit ne raste emergjencash zjarri.
30	Jeleke pune	copë	33	Ne funksion te sigurise teknike personeli ne kantier.
31	Kaska/Kokore	copë	33	Ne funksion te sigurise teknike mbrojtje shendeti personeli ne kantier
32	Rimorkiator - Terheqes	copë	1	Mjet terheqes I rimorkios qe sherben per transportin e makinerive te renda per ne kantier (eskavatora, rrula, grejdera, buldozera etj.)
33	Rimorkio kapacitet mbajtes mbi 30 ton per transportin e makinerive te renda per ne kantier (eskavatora, rrula, grejdera, buldozera etj.)	copë	1	Mjet per transportin e makinerive te renda per ne kantier (eskavatora, rrula, grejdera, buldozera etj.)

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

2.3.14. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të provojnë se janë në gjendje apo kanë të garantuar furnizimin e produkteve të asfaltit, binder, për sa më sipër duhet të disponojë në një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi materiale dhe duhet të paraqesë dokumentacionin për: **Implant Prodhiimi Asfalti pajisur me QKL në pronësi ose me kontratë materiale qeraje ose me kontratë materiale furnizimi.**

Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësise, të shoqëruar me leje mjedisore të lëshuar nga QKL si më poshtë:

QKL - Fabrike asfalti – Leje Mjedisi tipi B, Kodi:III.1.B., si dhe e pajisur me ISO 9001:2015, mbi certifikimin e cilësisë së asfaltit nga prodhuesi, si dhe të shoqërohet me Raport Monitorimi nga Organe të akredituara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të paktën 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Mbështetur në kërkesat e STASH 660-87 dhe STASH 561-87, duke ditur se përgatitja e asfaltit realizohet në temperaturën 155 °C deri në 170 °C, Fabrika/Impianti i prodhimit të Asfaltit duhet të jetë në një distancë **jo më të largët se 40 km** nga vendndodhja e objektit të prokurimit.

Kjo për arsye që të sigurohet se temperatura e domosdoshme për ngjeshjen e asfaltit jo më pak se **140 °C**, kusht teknik për ngjeshje referuar dhe V.K.M. Nr. 628, date 15.07.2015.

Në rast se ofertuesi disponon kontratë furnizimi noteriale, duhet të paraqitet dokumentacioni i lartpërmendur shoqëruar me kontratën noteriale të furnizimit (*e vlefshme përgjatë gjithë afatit të kësaj kontrate*), si dhe të shoqëruar me **deklaratën e garancisës prodhuesit/furnitorit** ku të jetë i përshkruar emërtimi i objektit që prokurohet, sasitë e kërkuara sipas preventivit dhe afati i furnizimit. Në rast se Operatori Ekonomik ofertues ka kontratë **furnizimi** noteriale ose kontratë noteriale **qeraje**(kjo kontratë duhet të jete vlefshme per periudhen e zhvillimit te prokurimit).

***Argumentimi:** Ky kriter u vendos ne perputhje me, neni 77, pika 4, ligji nr.162, date 23.12.2021 pasi ben te mundur dhe garanton, perputhshmerine dhe rregullsine e procesit te furnizimit, cilesine e produktit si dhe disponibilitetin te mallit me cilesine e kerkuar, pergjate ekzekutimit te kontrates. Aftësia e operatorëve ekonomikë për të ofruar mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative dhe besueshmërinë për të zbatuar kontratën. neni 77, pika 4, ligji nr.162, date 23.12.2021.Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Referuar VKM nr.628, datë 15.07.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve...specifikimet”, midis të tjerave parashikon se: **përzierja e prodhuar duhet zakonisht të transportohet menjëherë në kantierin e ndërtimit.** Sa me siper eshte marre parasysh sasite e kerkuara, si procesit teknik te furnizimit, dhe ai i vendosjes, pasi nuk jane mallra qe mund te magazinohen, si dhe nuk jane mallra qe mund te rrine ne gjendje magazinimi, nga vet **natyra fizike** e tyre (binder/asfaltobetone), por menjehere pas procesit te prodhimit ngakohen ne mjet, dhe dergohen ne vendin e vendosjes ne veper.*

Referuar nenit 2 gërma “b” “qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se; “qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mire përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës.

2.3.15.Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të provojnë se janë në gjendje apo kanë të garantuar furnizimin e produkteve rërë bituminoze,për sa më sipër duhet të disponojë në një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në pronësi **ose** me qira **ose** kontratë furnizimi noteriale, të paktën 1 (një) pikë/impiant për nxjerrje dhe përpunim të rërës bituminoze. Për këtë duhet të paraqesin:

- Kur është në pronësi: Të paraqitet dokumentacioni i pronësisë së pikës/implantit, shoqëruar me leje minerare “Përpunim dhe tregëtim i sterileve bituminoze dhe mbetjeve të tjera sterile të mbulesës ranore, rërave” (aktive), si dhe me leje mjedisore të lëshuar nga QKL - Leje Mjedisi kodi III.1.B për “Përpunim dhe tregëtim i sterileve bituminoze dhe mbetjeve të tjera sterile të mbulesës ranore, rërave”.
- Kur është marrë me qira apo me kontrate furnizimi: Të paraqitet kontrata noteriale e qirasë apo e furnizimit, shoqëruar gjithashtu me leje minerare “Përpunim dhe tregëtim i sterileve bituminoze dhe mbetjeve të tjera sterile të mbulesës ranore, rërave” (aktive), si dhe me leje mjedisore të lëshuar nga QKL - Leje Mjedisi kodi III.1.B për “Përpunim dhe tregëtim i sterileve bituminoze dhe mbetjeve të tjera sterile të mbulesës ranore, rërave”.

Argumentimi: Ky kriter u vendos ne perputhje me, neni 77, pika 4, ligji nr.162, date 23.12.2021 pasi ben te mundur dhe garanton, perputhshmerine dhe rregullsine e procesit te furnizimit, cilesine e produktit si dhe disponibilitetin te mallit te kerkuar, pergjate ekzekutimit te kontrates. Aftësia e operatorëve ekonomikë për të ofruar furnizim-vendosjen vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative dhe besueshmërinë për të zbatuar kontratën. neni 77, pika 4, ligji nr.162, date 23.12.2021.Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën si dhe referuar nenit 2 gërma “b” “qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mire përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës.

2.3.16.Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të provojnë se janë në gjendje apo kanë të garantuar furnizimin e produkteve inerte çakëll, stabilizant,për sa më sipërduhet të disponojë në një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në pronësi **ose** me qira **ose** kontratë furnizimi noteriale, për të paktën **1 (një) Implant prodhimi të materialeve Inerte** që parashikohen në preventivin e veprës si çakull dhe stabilizant. Për sa mësipër duhet të paraqitet dokumentacioni i pronësisë apo marrjes me qera, apo kontrate noteriale furnizimi, të shoqëruar me leje mjedisore të lëshuar nga QKL si me poshte: QKL – Impian/fabrike Inerte – Leje Mjedisi tipi B, Kodi:III.1.B., si dhe e pajisur me ISO 9001:2015, mbi certifikimin e cilësisë së inerteve nga prodhuesi, si dhe te shoqerohet me Raport Monitorimi nga Organe te akredituara prane Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit te pakten 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

Në rast se Operatori Ekonomik ofertues ka kontratë furnizimi noteriale, duhet të paraqitet dokumentacioni i lartepërmendur shoqëruar me kontratën noteriale te furnizimit (e vlefshme pergjate gjithe afatit te kesaj kontrate), si dhe me **deklaratën e garancisë së prodhuesit** ku të jetë i përshkruar emërtimi i objektit që prokurohet, sasitë e kërkuara dhe afati i furnizimit.

Argumentimi: Ky kriter u vendos ne perputhje me, neni 77, pika 4, ligji nr.162, date 23.12.2021 pasi ben te mundur dhe garanton, perputhshmerine dhe rregullsine e procesit te furnizimit, cilesine e produktit si dhe disponibilitetin te mallit te kerkuar, pergjate ekzekutimit te kontrates. Aftësia e operatorëve ekonomikë për të ofruar furnizim-vendosjen vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative dhe besueshmërinë për të zbatuar kontratën. neni 77, pika 4, ligji nr.162, date 23.12.2021. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën si dhe referuar nenit 2 gërma “b” “qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se; “qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mire përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Janë sipas të dhënave dhe shënimeve teknike në projektet e zbatimit, relacionet, specifikimet etj. bashkëlidhur DST-ve.

NJESIA E PROKURIMIT

Marije Bizdani

Gerald Bolani

Mateo Plaku